



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 gusht 2021
Nr. ref.: RK 1838/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI96/20

Parashtrues

Vegim Bllacaku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme [Rev.
nr. 352/2018], të 28 tetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Vegim Bllacaku, nga Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Rev. nr. 352/2018] e 28 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [Ac. nr. 856/2016] e 23 gushtit 2016 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C. nr. 1454/10] e 23 marsit 2012 të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
3. Parashtruesi i kërkesës aktvendimin e kontestuar e ka pranuar më 3 mars 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të lartcekura përmes të cilave, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 qershor 2020, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 23 qershor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
8. Më 3 korrik 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në po të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 3 korrik 2020, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) dhe kërkoi nga ajo dorëzimin e fletëkthesës që dëshmon se kur parashtruesi e ka pranuar aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

10. Më 7 korrik 2020, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se parashtruesi i kërkesës, Aktvendimin e kontestuar e kishte pranuar më 3 mars 2020.
11. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
13. Më 29 korrik 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Kompaninë e Sigurimit Fizik, Teknik dhe Elektronik WDG (në tekstin e mëtejme: Kompania WDG), në pozitën e rojës, sipas kontratës [0422/06] për një periudhë të caktuar, përkatësisht nga 1 marsi 2006 deri më 28 shkurt 2007.
15. Më 23 maj 2006, Kompania WDG mori vendim që të ndërpres punësimin e parashtruesit të kërkesës.
16. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër vendimit për ndërprerjen e punësimit të tij nga Kompania WDG.
17. Më 16 maj 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C1. nr. 153/2006] e anuloi vendimin e Kompanisë WDG për ndërprerjen e punësimit të parashtruesit të kërkesës dhe vendosi që ky i fundit të kthehet në vendin e punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës nga 23 maji 2006.
18. Më 26 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër Kompanisë WDG, me propozimin që të kompensohet financiarisht prej 23 majit 2006 e deri me 28 shkurt 2010, meqë Kompania WDG nuk e kishte zbatuar Aktgjykimin [C1. nr. 153/2006] e 16 majit 2007 të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
19. Më 23 mars 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C. nr. 1454/10] e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se Kompania WDG, më 1 korrik 2011, kishte përmbushur detyrimin e gjykuar financiar në emër të pagave të papaguara për periudhën 23 maj 2006 deri më 28 shkurt 2007, aq sa ishte e vlefshme kontrata e punës, në vlerë prej 2.393.59 euro. Për më tepër, Gjykata Komunale në Prishtinë arsyetoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte argumentuar kërkesën e tij për kompensim financiar mbi

atë se kishte kontratë të vlefshme të punës deri në vitin 2010 apo deri më 28 shkurt 2008.

20. Më 9 tetor 2012, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Kompanisë WDG, duke kërkuar që të detyrohet kjo e fundit që t'ia kompensojë pagat mujore, nga 28 shkurti 2007 deri më 26 qershor 2008, në vlerë prej 3.824.00 euro me kamatë ligjore.
21. Më 5 nëntor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktvendimit [C. nr. 2699/12] vendosi që të refuzojë padinë si të palejueshme me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte kontestuar Aktgjykimin [C. nr. 1454/10] e 23 marsit 2012 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, përmes të cilit ishte vendosur njëherë lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe ishin vërtetuar faktet lidhur me kompensimin financiar nga Kompania WDG, dhe rrjedhimisht, çështja konkrete e parashtruesit të kërkesës sipas Gjykatës Themelore në Prishtinë përbën tashmë çështje të gjykuara sipas nenit 166 dhe 391 të LPK-së.
22. Në një datë të specifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit [C. nr. 2699/12] të Gjykatës Themelore të 5 nëntorit 2015 në Gjykatën e Apelit me pretendimin për aplikim të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që të priset aktvendimi i kontestuar dhe çështja të kthehet në rigjykim.
23. Më 23 gusht 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 856/2016] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [C. nr. 2699/12] të 5 marsit 2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me arsyetimin se kjo e fundit e kishte vendosur/refuzuar tashmë pretendimin e parashtruesit sa i përket kompensimit financiar për periudhën 23 maj 2006 deri më 28 shkurt 2010.
24. Më 18 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës i dërgoi shkresë Kompanisë WDG dhe kërkoi që duke u bazuar në Aktgjykimin [C1. nr. 153/2006] të 16 majit 2006 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, t'ia mundësoj rikthimin në vendin e punës.
25. Në një datë të specifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit [Ac. nr. 856/2016] të 23 gushtit 2016 të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme me pretendimin për aplikim të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që të prishte aktvendimin e kontestuar dhe që çështja të kthehet në rigjykim.
26. Më 28 tetor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 352/2018] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, me arsyetimin se ky i fundit nuk ishte i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjithashtu për çështjen e njëjtë ekziston Aktgjykimi [C. nr. 1454/10] i 23 marsit 2012 të Gjykatës Komunale në Prishtinë. Gjykata Supreme, ndër të tjera, vlerësoi se neni 391, paragrafi 1 i LPK-së parasheh se gjykata hedhë poshtë padinë nëse konstaton se për çështjen e ngritur me padinë ekziston gjyqvarësia.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
28. Parashtruesi i kërkesës pretendon si në vijim: *“Sepse në Aktgjykimin C1.nr.153/2006 të Gjykatës Komunale të Prishtinës është përcaktuar qartë se Kompania e sigurimeve Fizike WDG e ka për detyrë të më kthej në vendin tim të punës dhe të më kompensojë të ardhurat nga marrëdhënia e punës deri në kthimin në vendin tim të punës. Ky aktgjykim nuk është përmbushur në tërësi nga Kompania WDG, e cila m'i ka realizuar pagesat vetëm për periudhën 23.05.2006 -28.02.2007, ndërsa për periudhën nga 28.02.2007 e deri 28.02.2008 sa kam qenë pa punë nuk më janë kompensuar të njëjtat sepse WDG nuk më ka kthyer në vendin tim të punës dhe e kanë shkëputur kontratën e punës pa më kthyer fare në vendin tim të punës. Kjo mos përmbushje nga detyrimi i Aktgjykimit C1.nr.153/2006 i plotfuqishëm i Gjykatës Komunale të Prishtinës e ka cenuar të drejtën time të punës si dhe të drejtën e ekzistencës sociale mua dhe familjes time, si mbajtës i familjes pa të ardhura mujore për ekzistencë”*.
29. Më tutje, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Po ashtu, nuk është marrë asnjë vendim tjetër nga kompania për shkëputjen e kontratës valide ndërmjet meje dhe punëdhënësit. Një fakt i tillë, nënkupton se unë kam qenë në marrëdhënie pune në kompaninë e sigurimit fizik WDG deri më 23.08.2008, kur duke parë se e njëjta nuk më mundësonte kthimin në punë, jam detyruar të krijoj marrëdhënie të re të punës”*.
30. Përgjatë pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Prandaj kërkesëpadia ime me nr. C.nr.2699/12 e 09. 10. 2012 nuk është gjë e gjykuar siç është e paraparë në nenin 166.2 të LPK-së sepse unë kam parashtruar padi për periudhën kohore sa kam qenë i papunë. Ndërsa kompania e sigurimit WDG ka qenë e detyruar të më kthej në vendin e punës, flasim këtu për periudhën kohore nga 01.03.2007 deri 23.06.2008. Ku për të njëjtën periudhë gjykata nuk ka vendosur dhe nuk ka kurrfarë aktgjykimi apo aktvendimi prandaj; nuk mund të thuhet se është gjë e gjykuar”*.
31. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, (iii) të deklarojë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 352/2018] të 28 tetorit 2019 dhe të kthej këtë të fundit në rivendosje.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.

Rregullore nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, i 8
tetorit 2001

Neni 10
Kontrata e punës

10.1 Kontrata e punës mund të lidhet:

- (a) për një kohë të pacaktuar ose
- (b) për një kohë të caktuar.

[...]

Neni 11
Shkëputja e kontratës së punës

11.1 Kontrata e punës shkëputet:

- (a) me rastin e vdekjes së punonjësit;
- (b) me marrëveshje me shkrim ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit;
- (c) në rastet e rënda të sjelljes së keqe nga punonjësit;
- (ç) për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga ana e punonjësit;
- (d) me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit; dhe

(dh) sipas fuqisë ligjore.

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

34. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç parashikohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashikojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

1. “Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]”.

35. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 352/2018] të 28 tetorit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
36. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:
- "(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*
37. Gjykata rikujton se në substancë pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës është shkelja e të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, me arsyetimin se në bazë të Aktgjykimit [C1. nr. 153/2006] të Gjykatës Komunale të Prishtinës të 16 majit 2007, Kompania WDG e ka kompensuar parashtruesin e kërkesës vetëm për periudhën sa kishte kontratë të vlefshme, respektivisht prej 23 majit 2006 e deri më 28 shkurt 2007, ndërsa sipas parashtruesit të kërkesës, Kompania WDG do të duhej ta kishte kompensuar edhe për periudhën pas përfundimit të kontratës së punës, respektivisht prej 28 shkurtit 2007 e deri më 28 shkurt 2008, me arsyetimin se kontrata e tij e punës ishte ndërprerë dhe rikthimi i tij në punë nuk kishte ndodhur asnjëherë, e gjitha kjo, sipas parashtruesit të kërkesës rezulton në moszbatim të plotë të Aktgjykimit [C1. nr. 153/2006] të Gjykatës Komunale të Prishtinës, të 16 majit 2007.
38. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [C1. nr. 153/2006] i Gjykatës Komunale të Prishtinës, të 16 majit 2007, nuk është zbatuar në tërësi nga Kompania WDG me arsyetimin se kjo e fundit për periudhën sa parashtruesi nuk ishte i punësuar dhe i rikthyer në punë, respektivisht për periudhën pas skadimit të kontratës, prej 28 shkurtit 2007 e deri më 28 shkurt 2008, nuk ishte kompensuar.
39. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në anën tjetër pretendon se Kompania WDG do të duhej ta kishte kompensuar deri më 23 gusht 2008, me arsyetimin se ka qenë në marrëdhënie pune edhe gjatë kësaj periudhe kohore dhe se Kompania WDG nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim formal për shpëputje të kontratës së punës të lidhur me datë 1 mars 2006.
40. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte kontratë për një periudhë të caktuar me Kompaninë WDG, nga 1 marsi 2006 deri më 28 shkurt 2007.

Ndërsa, marrëdhënia e tij e punës ishte ndërprerë nga Kompania WDG, më 23 maj 2006, pa i skaduar akoma kontrata e punës.

41. Gjkata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston vendimin për ndërprerjen e punësimit nga ana e Kompanisë WDG, duke iniciuar kontest gjyqësor fillimisht në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
42. Në këtë drejtim, Gjkata fillimisht iu referohet pjesës relevante të Aktgjykimit [C1. nr. 153/2006] të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 16 majit 2007, e cila vendosi si në vijim:

“APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Vegim Bllacaku nga Prishtina, ANULOHET si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës KS fizik WDG -SHA Drejtoria Qendrore në Kastriot, nr.1260106 I DT. 23.05.2006 me të cilin paditësit i është shkëputur kontrata e punës dhe DETYROHET e paditura që paditësin ta kthej në punë dhe detyra të punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës që nga dt. 23.05.2006, në afatin prej 8 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kanosjen e përmbarimit me dhunë”.

43. Gjkata vëren se Gjkata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C1. nr. 153/2006] të 16 majit 2007 kishte aprovuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kishte detyruar kompaninë WDG që ta kthej parashtruesin e kërkesës në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës që nga dita e largimit, përkatësisht nga 23 maji 2006, por sipas parashtruesit të kërkesës, Kompania WDG nuk e kishte rikthyer në punë – e kjo sipas tij përbën moszbatim në tërësi të këtij Aktgjykimi të Gjykatës Komunale në Prishtinë, i cili ishte në favor të parashtruesit të kërkesës.
44. Në vijim, Gjkata vëren se parashtruesi i kërkesës ishte ankuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar kompensimin financiar lidhur me pagat nga 23 maji 2006 deri më 28 shkurt 2010, periudhë kjo e cila përfshin kohën pas skadimit të kontratës së punës së parashtruesit të kërkesës me Kompaninë WDG - me arsyetimin se nuk ishte rikthyer në vendin e punës ashtu siç e përcaktonte Aktgjykimi [C1. nr. 153/2006] i 16 majit 2007, i Gjykatës Komunale në Prishtinë.
45. Në këtë kontekst, Gjkata do t'i referohet pjesës relevante të Aktgjykimit [C. nr. 1454/10] të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 23 majit 2012, i cili thekson se:

“E paditura me datën 01.07.2011 ndaj paditësit ka përmbushur obligimin financiar në emër të pagave të papaguara për periudhën 23.05.2006 deri me datën 28.02.2007, deri në afatin e vlefshmërisë së kontratës së punës dhe tabelës së pagave, në shumë të përgjithshme prej 2.393.59 euro, fakt jokontestues mes palëve. Shumë kjo e konfirmuar edhe me ekspertizën financiare sipas së cilës paga neto e paditësit ka qenë 239,93 euro. Andaj, gjykata vendosi si në dispozitiv meqenëse paditësi përkundër obligimit me dispozitën e nenit 7 dhe 319 të LPK-së nuk arriti të argumentoj se me të paditurën ka pas kontratë pune gjerë me vitin 2010, me saktësisht gjerë me 28.02.2008”.

46. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ishte kompensuar financiarisht nga Kompania WDG, në emër të pagave të papaguara për periudhën kohore sa kishte kontratë valide, përkatësisht prej 23 majit 2006 deri më 28 shkurt 2007, ndërsa për periudhën pas 28 shkurtit 2007, parashtruesi i kërkesës nuk kishte argumentuar se kishte kontratë pas kësaj periudhë, në mënyrë që t'i akordohet kompensimi financiar.
47. Në vazhdim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përsëri ishte ankuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë me pretendimin e njëjtë, duke kërkuar që të detyrohet Kompania WDG të kompensojë në emër të pagave mujore parashtruesin e kërkesës për periudhën 28 shkurt 2007 deri më 23 qershor 2008, në vlerë prej 3.824.00 euro, por ankesa e tij ishte refuzuar me arsyetimin se rasti i parashtruesit të kërkesës përbënte çështje të gjykuar në kuptim të nenit 166 dhe 391 të LPK-së sepse rasti i parashtruesit të kërkesës lidhur me pretendimin e tij për kompensim financiar gjerë më 23 qershor 2008 ishte trajtuar, vendosur dhe në fund ishte refuzuar përmes Aktgjykimit [1454/10] të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 23 majit 2012, i cili kishte arsyetuar si në vijim:

“Në seancën përgatitore të datës 05.11.2015, përfaqësuesi i të paditurës e ka njoftuar gjykatën se lidhur me çështjen konkrete juridike është zhvilluar edhe një procedurë tjetër pranë kësaj gjykate dhe në atë procedurë me aktgjykim C.nr.14541Jo të datës 23.03.2012, është refuzuar kërkesëpadia e paditësit për detyrimin e të paditurës për kompensimin e pagave për periudhën kohore 23.05.2006 deri me 28.02.2010, pra përfshirë edhe periudhën kohore për të cilën është paraqitur padia e datës 09.10.2012. Gjykata pasi vlerësoi provën e prezantuar gjegjësisht, aktgjykimin C.nr.1454/10 dhe pas vërtetimit të faktit se kundër aktgjykimit në fjalë, paditësi nuk ka paraqitur ankesë, kështu bazuar në faktin se çështja konkrete juridike përbën çështje të gjykuar, konform nenit 166, pika 2 dhe nenit 391, paragrafit 1) pikës (d) të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) ...”.

48. Më tutje, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës më pas ishte ankuar në Gjykatën e Apelit, e cila kishte refuzuar ankesën si të pabazuar përmes Aktvendimit [Ac. nr. 856/2016] të 26 gushtit 2016, e cila ndër të tjera, kishte arsyetuar si në vijim:

“Pretendimet ankimore të paditësit kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara pasi që gjykata e shkallës e parë nuk ka bërë aplikim të gabuar të së drejtës materiale për të cilën kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e në anën tjetër nga shkresat e lëndës shihet qartë se Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin C.nr.1454/20 10 të datës 23.03.2012 e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për detyrimin e të paditurës për kompensimin e pagave për periudhën 23.05.2006 gjerë me datën 28.02.2010, pra përfshirë edhe periudhën kohore për të cilën është paraqitur padia e paditësit për kompensimin e të ardhurave personale”.

49. Në fund, Gjykata vëren po ashtu se revizioni i paraqitur kundër aktvendimit të lartcekur në Gjykatën Supreme ishte refuzuar nga kjo e fundit përmes

Aktvendimit [Rev. m. 352/2018] të 28 tetorit 2019, i cili kishte arsyetuar si në vijim:

“Vlerësimi i gjykatave të instancave më të ulëta mbi palejueshmërinë e padisë ka mbështetje në dispozitat ligjore. Neni 391, par 1 pika (d) i LPK-së parashikon se gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se çështja është gjë e gjykuar (res iudicata). Në rastin konkret, për çështjen e njëjtë ekziston aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në Prishtinë, C. nr. 1454/10 dt.23.03.2012 ...”.

50. Gjkata vëren se Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C1. nr. 153/2006] të 16 majit 2007 vendosi që parashtruesin e kërkesës ta kthej në vendin e punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës nga 23 maji 2006.
51. Gjykata vëren se punëdhënësi, përkatësisht Kompania WDG, e kishte kompensuar financiarisht në emër të pagave mujore parashtruesin e kërkesës në vlerë 2.393.59 euro për periudhën nga 23 maji 2006, dita kur ishte larguar nga puna, deri më 28 shkurt 2007, ditën kur parashtruesit të kërkesës i skadonte kontrata e punës.
52. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Kompania WDG për periudhën nga 28 shkurti 2007, dita kur kontrata e punës skadonte, e deri më 28 shkurt 2008 nuk është kompensuar duke përfshirë periudhën edhe pas skadimit të kontratës dhe në fund as nuk është kthyer në vendin e punës.
53. Gjykata vëren se kontrata e punës së 1 marsit 2006 e lidhur në mes parashtruesit të kërkesës dhe Kompanisë WDG ishte krijuar duke u mbështetur në dispozitat 9, 10 dhe 11 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, të 8 tetorit 2001.
54. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se neni 11.1, paragrafi d) i Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, të 8 tetorit 2001, përcaktonte shprehimisht se *“Kontrata e punës shkëputet me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit ...”*.
55. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte kontratë me afat të caktuar, më saktësisht nga 1 marsi 2006 e deri më 28 shkurt 2007 dhe i është realizuar e drejta e kompensimit të të ardhurave vetëm për periudhën deri sa kishte kontratë me Kompaninë WDG, dhe se kjo kontratë nuk përbënte siguri që parashtruesit do t’i vazhdohej marrëdhënia e punës nga punëdhënësi edhe pas skadimit të saj.
56. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që parashtruesit të kërkesës i është akorduar kompensimi financiar në vlerë prej 2.393.59 euro, për kohën sa ishte larguar nga puna.
57. Gjykata më tej dëshiron të thekson se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë nuk ka përcaktuar se punëdhënësi, gjegjësisht Kompania WDG, duhet që të ripërtërijë marrëdhënien e punës me parashtruesin e kërkesës pas përfundimit të kontratës me afat të caktuar.

58. Për sa i përket pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta shpjeguan dhe arsyetuan se përse parashtruesit të kërkesës iu refuzua kërkesa për kompensimin e pagave për periudhën sa nuk kishte kontratë me punëdhënësin.
59. Gjykata dëshiron të sqarojë se nuk është detyrë e saj që të shqyrtojë nëse gjykatat e rregullta, në këtë rast Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, me aktvendimet e tyre kanë interpretuar drejt ligjin e aplikueshëm, por të shqyrtojë dhe të marr parasysh nëse ajo me vendimet e tyre të lartpërmendura kishin cenuar të drejtat dhe liritë individuale të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
60. Gjykata ka parasysh se parashtruesi gjithashtu pretendon se *“kërkesëpadia ime me nr. C.nr.2699/12 e 09.10.2012 nuk është gjë e gjykuar siç është e paraparë në nenin 166. 2 të LPK-së sepse unë kam parashtruar padi për periudhën kohore sa kam qenë i papunë”*.
61. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se kërkesa e tij [C. nr. 2699/12] e 9 tetorit 2012 drejtuar Gjykatës së Apelit nuk përbën çështje të gjykuar siç është vlerësuar nga kjo e fundit përmes Aktvendimit [AC. nr. 856/2016] të 23 gushtit 2016, sepse padia e parashtruesit të kërkesës kishte të bënte me kompensimin e pagave për një periudhë tjetër, përkatësisht prej 28 shkurtit 2007 deri më 23 qershor 2008.
62. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 856/2016] të 23 gushtit 2016 kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës si të pathemeltë, duke u bazuar në nenin 208 dhe 209, paragrafi (b) të LPK-së, pasi që pretendimi i parashtruesit për kompensimin e pagave për periudhën sa ishte i papunë ishte vendosur dhe sqaruar në mënyrë të drejtë nga Gjykata Themelore e Prishtinës përmes Aktvendimit [C. nr. 2699/12] të 15 nëntorit 2015, pasi që, sipas kësaj të fundit, në bazë të nenit 166 dhe 391 të LPK-së, kërkesa e parashtruesit përbënte çështje të gjykuara ngase çështja e kompensimit të pagave gjatë periudhës sa parashtruesi nuk kishte kontratë pune ishte shqyrtuar dhe refuzuar përmes Aktgjykimit [C. nr. 1454/10] të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 23 marsit 2012.
63. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C. nr. 1454/10] të 23 marsit 2012, lidhur me pretendimin e parashtruesit për kompensimin e pagave për periudhën pas 28 shkurtit 2007, kishte vlerësuar se *“... paditësi përkundër obligimit me dispozitën e nenit 7 dhe 319 të LPK-së nuk arriti të argumentoj se me të paditurën ka pas kontratë pune gjerë në vitin 2010, më saktësisht gjerë më 28.02.2008”*.
64. Gjykata vëren se vendimet e gjykatave të rregullta adresuan ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe në fund shpjeguan se përse iu refuzua kërkesa në lidhje me pretendimet e tij, e që kryesisht kishte të bënte me mosofrimin e provave dhe fakteve të besueshme për ekzistimin e të drejtës së pretenduar dhe ekzistimin e një marrëdhënie kontraktuale me Kompaninë WDG për periudhën 28 shkurt 2007 deri me 28 shkurt 2008, në mënyrë që t’i akordohet kompensimi i pagave.

65. Gjykata thekson se në praktikën e saj gjyqësore në shumë raste ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit janë brenda fushëveprimit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë antikushtetuese (shih, mes tjerash, Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI33/16, parashtruese *Minire Zeka*, Aktgjykim i 4 gushtit 2018, paragrafi 91; Shih, *mutatis mutandis*, rasti i Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012; rasti KI122/18, parashtruesi i kërkesës *Limak Kosovo International Airport J. S. C. "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2019, paragrafi 56; rasti KI128/19, parashtrues i kërkesës *Artan Mala*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 40).
66. Rrjedhimisht, roli i Gjykatës Kushtetuese është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmerr masa kur argumentohet se një gjykatë e rregullt ka "*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*" në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin e kërkesës. (Përkitazi me parimet themelore në lidhje me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, shih ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 gushtit 2019, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty). (Shih, në këtë kontekst, po ashtu rastin e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83; dhe gjithashtu, rastet e Gjykatës KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 40; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 59).
67. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtruesit të kërkesës, duhet pasur parasysh se "drejtësia" që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi "*substanciale*", por drejtësi "*procedurale*". Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës. (Shih gjithashtu rastin e Gjykatës nr. KI42/16 parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55).
68. Gjykata, vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit të tij. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

69. Prandaj, bazuar në si më sipër, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtuesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij se procedurat pranë gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se përmes Aktvendimit të kontestuar i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
70. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 29 korrik 2021 njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka Nimani